



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 855 prot.

Tiranë, më 13.07.2023

V E N D I M

Nr. 129 , datë 13.07.2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 200 Regj., datë 19.12.2022, të shtetases L. D, kundër Bashkisë Fier, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjinisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, subjekti ankues, L. D, informon Komisionerin lidhur me problematikën e saj me ish-punëdhënësin, Bashkinë Fier, për të cilën shprehet se:

“Kam qenë e punësuar si specialiste e Financës pranë Bashkisë Fier, që nga data 11.11.2013. Para se të mbushja moshën për daljen në pension pleqërie (me datë 15.06.2022), me datë 12.05.2022, i jam drejtuar me shkresë Drejtorisë së Burimeve e Shërbimeve Njerëzore, pranë Bashkisë, duke kërkuar shtyrjen e daljes në pension për një periudhë një vjeçare, për arsye familjare, nisur nga rrethanat financiare, pasi kam një kredi që më mbaron me datë 15.04.2023. Duke qenë se dhe bashkëshortin e kam pa punë, unë kam burimin e vetëm të të ardhurave në familje.

Po me datë 12.05.2022, Bashkia i është drejtuar me shkresë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), duke kërkuar zgjatjen e qëndrimit tim në detyrë deri me datë 15.06.2023.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Me datë 12.10.2022 – 11.11.2022, kam qenë me leje vjetore, periudhë gjatë së cilës për arsye familjare ndodhesha jashtë shtetit.

Me datë 14.10.2022, dy ditë pasi unë kam filluar lejen, Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me datë 11.10.2022, urdhër i cili më është komunikuar me datë 15.11.2022.

Po me datë 14.10.2022, Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Pronave të kësaj Bashkie, i është njoftuar shkresa e Kryetarit të Bashkisë (me nr. 8748 prot., datë 14.10.2022), sipas së cilës unë do të vazhdoj të jap kontributin tim deri me datë 11.10.2022, për shkak të moskthimit të përgjigjes nga KMSHC.

Në këto kushte, ky urdhër i Kryetarit të Bashkisë është tendencioz dhe përbën cënim të dinjitetit tim, diskriminim njerëzor, profesional.”.

Ankuesja ka pretenduar se punëdhënësi e ka trajtuar atë në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme, krahasuar me punonjës të tjerë meshkuj, të cilët edhe ata kishin mbushur moshën e daljes në pension, por që u është zgjatur qëndrimi në detyrë nga ana e Bashkisë, pavarësisht faktit se KMSHC po ashtu nuk kishte kthyer përgjigje njëjloj si për rastin e saj.

Pra, ankuesja ka pretenduar se Bashkia ka favorizuar punonjësit e tjerë meshkuj, krahasuar me atë, megjithëse ndodheshin në kushte të njëjta, duke e vënë haptazi atë në pozita diskriminuese bazuar në shkaqe gjinore.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim të saj nga ana e Bashkisë Fier dhe rikthimin e saj në detyrën e mëparshme.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “aftësisë së kufizuar”, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë,

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun II, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, të tij parashikon se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.....”

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 1611/1 prot., datë 23.12.2022, Komisioneri i është drejtuar Bashkisë Fier, duke kërkuar informacion dhe dokumentacion provues, sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Fier, me shkresën nr. 11241/1 prot., datë 04.01.2023, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera, si vijon:

“L. D ka ushtruar detyrën e specialistes së pagave, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, pranë Bashkisë Fier, që prej datës 11.11.2013, deri në datë 11.10.2022, datë në të cilën ka ndërprerë marrëdhëniet financiare me Bashkinë, për shkak të lirit nga detyra, për plotësim të moshës së pensionit, që për ankuesen rezultoi të jetë moshë 61 vjeç e 4 muaj. Sqarojmë se ky kriter për ankuesen është plotësuar që prej datës 15.06.2022 dhe deri në datën 11.10.2022, znj. D ka dhënë kontributin e saj pranë Bashkisë Fier, pra 4 muaj përtej datës që duhet të përfitonte pensionin e pleqërisë, dhe se pretendimi i saj për diskriminim për shkak të “gjinisë” nuk qëndron.

Nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kërkuar marrja e masave dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës në shërbimin civil, për punonjësit që mbushin moshën e pensionit.

Theksojmë se, nga ana e Bashkisë është lejuar vijimi i dhënies së kontributit profesional në detyrë nga ana e znj. D, deri në momentin e paraqitjes së kërkesave nga ana e personave të interesuar për këtë pozicion pune, në Bashkinë Fier, ku deri në datë 11.10.2022 janë paraqitur 5 kërkesa për punësim, pas shpalljes së vendit të lirë të punës. Në këtë pozicion pune është emëruar Xh. S.

Në lidhje me punonjësit e tjerë meshkuj, me të cilët ankuesja ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë, ky pretendim nuk qëndron pasi, në lidhje me fushën, profesionin dhe pozicionin që këta punonjës gëzojnë, nuk janë paraqitur persona të tjerë të cilët të kenë shprehur interes për vendet e punës të publikuara, dhe në këto kushte, është ndjerë e nevojshme dhënia e kontributit të tyre profesional, për Bashkinë Fier, që kjo e fundit të jetë koherente në realizimin e shërbimeve që ligji përkatës ka përcaktuar për pushtetin vendor. Nga ana e Bashkisë janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore konform parashikimeve ligjore duke i akorduar edhe shpërblimin në masën e një page mujore, për shkak të daljes në pension dhe në asnjë moment ajo nuk është diskriminuar”.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 377 prot., datë 09.03.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.
3. Nëpërmjet shkresës me nr. 377/1 prot., datë 05.04.2023, palët u njoftuan se bazuar në kërkesën e subjektit ankues, seanca do të zhvillohet me datë 13.04.2023.

Lidhur me trajtimin me sa më objektivitet të çështjes, si dhe në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor, Komisioneri ka kërkuar paraprakisht, që palët në proces të sjellin informacion, prova, si dhe fakte të reja, që mund të mbështesin pretendimet e tyre, lidhur me sa më sipër.

4. Seanca u zhvillua në datë 13.04.2022, me praninë e subjektit ankues dhe L. M, përfaqësues me autorizim, i Bashkisë Fier, i cili mban detyrën e juristit në Drejtorinë e Përgjithshme të Legjislacionit/Drejtoria Juridike, pranë Bashkisë Fier.

Gjatë seancës dëgjimore, si subjekti ankues, ashtu edhe përfaqësuesi i Bashkisë Fier, iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim, gjatë arsyetimit të vendimit. Bashkisë Fier iu la si detyrë që të depozitonte pranë KMD-së, në vijim, dokumentacionin provues lidhur me shpalljet e bëra nga Bashkia për vendet vakante të cituara prej tyre. Po ashtu, të dyja palëve iu bë e ditur se mund të depozitonin në vijim të seancës, parashtrime, prova e fakte të tjera shtesë të cilat mbështesnin pretendimet e tyre.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës me nr. 2984/1 prot., datë 27.04.2023, Bashkia Fier depozitoi dokumentacionin e kërkuar, i cili do të referohet në vijim të analizës e arsyetimit të Komisionerit në pjesën e tretë (III-të) të këtij vendimi.

6. Nëpërmjet e-mailit të datës 05.07.2023, Bashkia informoi Komisionerin se:

“Ju sqarojmë se procesi gjyqësor me palë paditëse L. Du dhe palë të paditur Bashkia Fier ka përfunduar dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, në seancën gjyqësore të datës 23.06.2023, me vendimin nr. 84-2023-637, ka vendosur "Rrëzimin e kërkesëpadisë". Duke qenë se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, që prej datës 01.07.2023 është transferuar në Lushnje, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin që Bashkisë Fier nuk i është komunikuar ende vendimi i zbardhur, po ju vendosim në dispozicion brenda afatit të përcaktuar nga ana juaj, një kopje të dispozitivit të vendimit të nxjerrë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Në këtë kontekst, në ankesën në fjalë, është analizuar dhe vlerësuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme krahasuar me punonjësit: M. M, H. A, K. Q dhe F. Z.

A. 1. Lidhur me trajtimin e pabarabartë e të pafavorshëm të ankueses nga ana e Bashkisë Fier.

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

Subjekti ankues, ka kryer detyrën e “specialistit të pagave”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Buxhetit, Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Pronave, në Bashkinë Fier, që nga data 11.11.2013 deri në datë 11.10.2022.

Para se të mbushte moshën për daljen në pension pleqërie (me datë 15.06.2022), me kërkesën me nr. 4044 prot., datë 12.05.2022, ankuesja i është drejtuar me shkresë Drejtorisë së Burimeve e Shërbimeve Njerëzore, pranë Bashkisë, duke kërkuar shtyrjen e daljes në pension për një periudhë një vjeçare, për arsye familjare, nisur nga rrethanat financiare e familjare.

Po me datë 12.05.2022, kjo Drejtori i është drejtuar Bashkisë me shkrim lidhur me kërkesën për shtyrje të afatit të daljes në pension, për një periudhë një vjeçare për punonjësën L. D.

Bashkia nëpërmjet shkresës me nr. 3719/1 prot., datë 30.05.2022, i është drejtuar me shkresë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), duke kërkuar, ndër të tjera zgjatjen e qëndrimit në detyrë të 5 (pesë) punonjësve, ndër të cilët edhe për ankuesen, për të cilën ka kërkuar konkretisht, të qëndrojë në detyrë deri me datë 15.06.2023.

Komisioneri, vëren se, kjo shkresë e Bashkisë Fier është hartuar në kuadër të informacionit të kërkuar nëpërmjet shkresës me nr. 400 prot., datë 04.05.2022, të KMSHC, me lëndë: “Kërkesë për informacion në lidhje me nëpunësit civil të cilët kanë plotësuar kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë”.

Rreth 5 (pesë) muaj nga kërkesa e Bashkisë drejtuar KMSHC lidhur me ankuesen, dhe 4 (katër) muaj pasi ajo kishte plotësuar moshën e daljes në pension, me Urdhrin nr. 729, datë 14.10.2022 të Kryetarit të Bashkisë³, ankuesja është liruar nga pozicioni “specialist për pagat”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Buxhetit, Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Pronave, në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit/Bashkia Fier, për shkak se ka plotësuar moshën për të dalë në pension.

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 31 dhe 92, të tij, ka parashikuar se:

“Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të plotë në moshën 65 vjeç burrat dhe 60 vjeç gratë, pasi të kenë plotësuar 35 vjet sigurim. Për periudhën e tranzicionit bëhet përjashtim nga ky rregull dhe zbatohet neni 92 i dispozitave tranzitore të këtij ligji.

... Moshë dhe periudha e sigurimit për pension të plotë pleqërie, deri në arritjen e moshës dhe plotësimin e periudhës së sigurimit, që përcaktohen në pikën 1 të nenit 31 të ligjit, rriten sipas tabelave që vijojnë: ...

...për gratë, kategoria e III-të, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, dalin në pension pleqërie, në moshën 61 vjeç dhe 4 muaj”.

³ Komisioneri konstaton se shkresa ka pasaktwsi e mospwrputhje nw data, lapsuse materiale.

Duke qenë se ankuesja ka gëzuar statusin e nëpunësit civil, referuar nenit 65, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar, lidhur me sa më sipër, parashikohet se:

“1. Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon për shkak të ligjit kur:

c) plotësohet moshë për pensionin e plotë të pleqërisë...”

Bazuar në sa më lart, ankuesja është e datëlindjes 15.02.1961, dhe ky kriter është plotësuar në datën 15.06.2022, megjithatë, përtej kësaj date, deri në datë 11.10.2022 ka vijuar të jetë në marrëdhënie pune me Bashkinë Fier, për një periudhë kohore prej rreth 4 muaj pas mbushjes së moshës për daljen në pension, pavarësisht se Ligji “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, shprehet qartë se me plotësimin e moshës për pensionim, punonjësit, për shkak të ligjit, i përfundon marrëdhënia në shërbimin civil.

Përsa i përket, trajtimit të pabarabartë e të pafavorshëm, krahasura me punonjësit e tjerë të Bashkisë, për të cilët ankuesja ka pretenduar se janë favorizuar nga ana e titullarit të Institucionit, Komisioneri, bazuar në aktet e disponuara në këtë proces, ka konstatuar se:

- Nga të dhënat e tabelës së paraqitur në shkresën me nr. 3719/1 prot., datë 30.05.2022, të Bashkisë Fier, nëpunësit civilë të cilët kanë plotësuar moshën për pension të plotë pleqërie dhe aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punës janë 2 (dy), ndërsa punonjësit që plotësojnë moshën deri me datë 31.12.2022 janë 3 (tre), ndër të cilët edhe ankuesja.
- Kështu, referuar të dhënave të tabelës si më poshtë, rezulton se:

A. Punonjësit që kanë plotësuar moshën për daljen në pension të plotë pleqërie

Nr.	Emër/Mbiemër	Pozicioni i punës	Datëlindja	Data e plotësimit të moshës për pension të plotë pleqërie
1.	z. M . M	Specialist i nivelit të lartë Agronom në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës	02.04.1957	02.04.2022
2.	z. H. A	Drejtor i Drejtorisë së Projekteve të Infrastrukturës dhe Njesisë së Integritimit Evropian	06.12.1954	06.12.2019

B. Punonjësit që plotësojnë moshën deri në datën 31.12.2022

Nr.	Emër/Mbiemër	Pozicioni i punës	Datëlindja	Data e plotësimit të moshës për pension të plotë
-----	--------------	-------------------	------------	--

				pleqërie
1.	znj.L. D	Specialist i nivelit të lartë për pagat në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit	15.02.1961	15.06.2022
2.	z. K. Q	Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike	08.07.1961	08.11.2022
3.	znj. F. Z	Specialist i nivelit të lartë/Arkivist në Drejtorinë e Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore	12.12.1957	12.12.2022

Bazuar në kërkesat e protokolluara pranë Bashkisë Fier, depozituar pranë KMD-së, rezulton se, të gjithë punonjësit, të cilët kishin plotësuar apo plotësonin moshën për daljen në pension, deri me datë 31.12.2022, kanë kërkuar respektivisht që marrëdhëniet e punës me Bashkinë t'u shtyheshin deri në një vit më tepër sesa data e përfundimit të marrëdhënieve të punës për shkak të ligjit (plotësimi të moshës për daljen në pension).

Këto kërkesa të 5 punonjësve: ankueses, M. M, H. A, K. Q dhe F. Z janë marrë në konsideratë nga ana e punëdhënësit, pasi, sipas komunikimit shkresor mes Bashkisë dhe KMSHC, rezulton se ky i fundit nëpërmjet shkresës me nr. 3719/1 prot., datë 30.05.2022, është informuar e sqaruar nga ana e Bashkisë, se:

“- Me vendimin nr. 9, datë 07.02.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, është vendosur që marrëdhënia në shërbimin civil për punonjësën H. A, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Projektiveve, në Bashkinë Fier, të vazhdojë deri në plotësimin e këtij vendi.

- Për punonjësën M M, me detyrë specialist i lartë agronom në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, është bërë kërkesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Veterinarisë, Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Bujqësore, Administrimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve, për qendrmin në punë, për shkak të ngarkesës së madhe që mban ky pozicion pune, si dhe për shkak të detyrave që ai kryen në zgjidhjen e problematikave në drejtim të ujitjes, kullimit dhe asistencës teknike që jep.

- Punonjësja L. D, e cila del në pension në datë 15.06.2022, ka depozituar kërkesë për shtyrjen e afatit të daljes në pension, për arsye ekonomike. Gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit të Pronave, kërkohet shtyrja e datës së daljes në pension për këtë punonjëse, për një periudhë një vjeçare, për arsye të ngarkesës së punës që ka kjo Drejtori”.

Në mungesë të kthimit të përgjigjes apo konfirmimit të kërkesës së Bashkisë Fier, lidhur me sa më sipër, Bashkia ka vijuar marrëdhëniet e punës me punonjësit sipërcituar, të cilët në momentin e kërkesës drejtuar KMSHC, kishin plotësuar moshën për daljen në pension, që

ishin: subjekti ankues, M. M dhe H. A. (Pasi dy punonjësit e tjerë K. Q dhe F. Z, plotësonin moshën e daljes në pension në muajt pasardhës, përkatësisht në nëntor dhe dhjetor 2022).

Komisioneri vëren se, për punonjësin M. M, i cili kishte plotësuar moshën për daljen në pension që në datë 06.12.2019, Bashkia ka vijuar marrëdhëniet e punës edhe përtej këtij afati, pasi bazuar në vendimin e KMSHC, është vendosur që ai të vijonte në punë deri në përfundim të procedurës së rekrutimit për plotësimin e këtij vendi pune.

Nëpërmjet shkresave me nr. 8412 prot., dhe me nr.8413 prot., datë 06.10.2022, Bashkia Fier i është drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit lidhur me kërkesën për publikim të pozicioneve të lira të punës, (pozicione të cilat më pas janë shpallur nga Bashkia), ndër të cilat rezultojnë edhe pozicionet e punës që mbuloreshin nga punonjësit të cilët kishin plotësuar moshën për daljen në pension.

Kështu, rezulton të jenë shpallur procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë për 21 pozicione Drejtor Drejtorie, kategoria II- b dhe Përgjegjës Sektori, kategoria III - a, si dhe 14 pozicione për specialist, kategoria III-b; pozicione këto, 3 nga të cilat aktualisht mbuloreshin nga punonjësit: M. M, H. A dhe ankuesja.

Pas shpalljes së pozicioneve të lira të punës (06.10.2022), bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga ana e Bashkisë Fier, rezulton se:

- Për pozicionin e punës “Specialist i nivelit të lartë për pagat në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit”, pozicioni i cili mbulohej nga ankuesja, janë paraqitur 5 kërkesa.
- Për pozicionet që mbuloreshin nga dy punonjësit me të cilët ankuesja krahasohet, për periudhën të cilës asaj i ka përfunduar marrëdhëniet në shërbimin civil, për shkak të ligjit, nuk është paraqitur asnjë kërkesë, nëpërmjet të cilës të shprehet interesi për këto pozicione, pozicione të cilat lidheshin me fushën e profesionit që kërkohej (agronom i lartë apo inxhinier).

Duke u bazuar në mungesën e kërkesave për dy pozicionet sipërcituar, punëdhënësi ka shtyrë afatin e daljes në pension për një periudhë deri 1 (një) vjeçare për punonjësit M. M dhe H. A, ndërsa me ankuesen ka vijuar procedurën për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit.

I njëjti arsyetim vlen edhe për punonjësin F. Z, të cilit i është shtyrë afati i daljes në pension, në muajin dhjetor 2022, periudhë pasi ankueses i kishte përfunduar marrëdhëniet e punës me Bashkinë Fier, për shkak të ligjit. Ndërsa lidhur me punonjësen tjetër, K. Q, palët pohuan se ajo kishte dhënë dorëheqjen nga pozicioni i punës, vullnetarisht.

Komisioneri vlerëson se, vijimi i marrëdhënieve të punës edhe pas plotësimit të moshës për daljen në pension është në kompetencën e të drejtën diskrecionale të punëdhënësit dhe vlerësimin e nevojës e situatës aktuale të institucionit.

Shtyrja e afatit të daljes në pension të punonjësit/nëpunësit është parashikuar në legjislacionin përkatës si *një mundësi* kur përmbushen këto kushte njëkohësisht:

- Kërkesa e bazuar në vullnetin e punonjësit për të vazhduar marrëdhëniet e punës tej moshës së pensionit;
- Nevoja e punëdhënësit për të vazhduar edhe më tej marrëdhëniet e punës me personin/punonjësin që i ka lindur e drejta e pensionit, për shkak të përvojës së punonjësit aktual dhe mungesës së personelit rekrutues, etj;
- Si dhe, miratimit të punëdhënësit për sa më sipër.

Për ankuesen, por edhe për çdo punonjës tjetër në kushtet e saj, e drejta për të dalë në pension kur plotësohen kushtet ligjore, është një e drejtë themelore dhe që mbrohet me ligj.

Mos nxjerrja në pension pleqërie e punonjësit nga punëdhënësi (kur janë përmbushur kushtet ligjore) do të përbënte shkelje e diskriminim, dhe kjo e drejtë mbrohet me ligj.

Komisioneri, vëren se, vazhdimi i punës tej moshës së caktuar për të dalë në pension, është një *mundësi*, sipas kushteve sipërcituar, dhe se, mos realizimi i kësaj mundësie, në parim, nuk cenon asnjë të drejtë të punonjësit, dhe për më tepër të shihet si sjellje diskriminuese.

Për rrjedhojë, kushti themelor për vazhdimin e marrëdhënieve të punës, tej afatit të plotësimit të moshës së caktuar për pension, është dakordësia mes palëve: punëdhënës-punëmarrës.

Ashtu sikundër punëdhënësi nuk mund të mbajë në punë punëmarrësin, pa dëshirën e këtij të fundit, ashtu dhe punëmarrësi nuk mund të vazhdojë marrëdhënie e punës (kur ka plotësuar moshën për daljen në pension) pa dakordësinë e punëdhënësit.

Gjykata e Lartë⁴ në jurisprudencën e saj ka vendosur që njerëzit që kanë arritur një moshë të caktuar, nuk mund të qëndrojnë më në sektorin publik; autoritetet shtetërore që veprojnë në cilësinë e punëdhënësit, në rast të arritjes së moshës së pensionit nga nëpunësi civil, duhet të vazhdojnë me zgjidhjen e kontratës së punës. Në këtë kontekst vlerësohet edhe interesi dhe e drejta e personave të tjerë për t'u punësuar, ushtruar profesionin dhe për dhënie e kontributit profesional nga ana e tyre.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankuesja ka qenë në marrëdhënie punë në sektorin publik dhe punëdhënësi është institucion publik shtetëror. Shteti, si rregullator dhe zbatues i politikave të punësimit, ka detyrim të krijojë vende pune ndër të tjera edhe në sektorin publik duke përfunduar marrëdhëniet e punës të personave që mbushin moshën e pensionit dhe punësimin e të papunëve.

Komisioneri vlerëson se, në frymën e mësipërme ka dalë dhe VKM nr. 478, datë 16.06.2010 "*Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie*", dhe sipas pikës 4 të këtij vendimi, organet shtetërore me cilësinë e punëdhënësit kur punëmarrësit mbushin moshën për pension pleqërie,

⁴ Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, Mehmet Paja kundër Drejtorisë Arsimore të Beratit, datë 03.04.2014

sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.005.1993 "*Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, dhe ligjit "*Për Nëpunësin Civil*", të ndryshuar, kanë detyrimin të ndërpresin menjëherë marrëdhëniet e punës. Në këto kushte nuk mund të vazhdojnë marrëdhëniet e punës të një personi të punësuar në administratën publike që ka mbushur moshën për pension. Në bazë të këtij rregullimi nënligjor punëdhënësi/organi shtetëror ka detyrimin të përfundojë marrëdhënien e punës, duke bërë përjashtim rastet e veçanta dhe specifike, bazuar në nevojat e institucionit dhe vullnetin reciprok punëdhënës-punëmarrës.

Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se nga ana e Bashkisë Fier është ndjekur e njëjta procedurë lidhur me vlerësimin e shtyrjes së afatit të daljes në pension për të gjithë punonjësit që kishin plotësuar moshën për daljen në pension pleqërie, përfshirë edhe vetë ankuesen, me të cilët ajo është krahasuar dhe ka pretenduar trajtim të pabarabartë e të pafavorshëm nga ana e Bashkisë.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme, pasi ajo ndodhej në kushte jo të njëjta me punonjësit e tjerë, pasi për pozicionet e punonjësve të tjerë, të shpallura vakante nuk kishte kërkesa dhe interes të shprehur; ndërsa e kundërta rezultoi për ankuesen - për pozicionin e saj ishin depozituar 5 kërkesa, pas shpalljes së pozicionit të punës "Specialist i Lartë e Pagave".

Për më tepër, Komisioneri vëren se, Bashkia ka vijuar marrëdhëniet e punës me ankuesesën, përtej plotësimit të moshës së pensionit, deri momentin kur për këtë pozicion të shpallur pune (si për çdo pozicion tjetër pune të shpallur) janë paraqitur persona që kanë shprehur interesin dhe kanë depozituar kërkesat për t'u emëruar në këtë pozicion pune.

Fakti që për pozicionet e tjera të punës (që mbaheshin nga punonjësit me të cilët ajo krahasohet) nuk është shprehur interes apo nuk janë depozituar kërkesa nga ana e personave të interesuar, nuk e ngarkon me përgjegjësi institucionin.

Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, nisur nga kushtet e rrethanat objektive të rastit të saj, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Fier.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Fier, ardhur për shkaqe gjinore kundrejt subjektit ankues.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, L. D, në fushën e punësimit, për shkak të gjinisë, nga ana e Bashkisë Fier.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA